



GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Xhemail Dervishi nga fsh.Grdic Komuna e Glllogocit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.14838/12, datë 30.06.2012, në bazë të nenit 39 al.3, konform të nenit 221. të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 14.09.2012, mori

K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e **PABAZUAR**.


VËRTETOHET aktvendimi i atakuar si i drejt dhe i bazuar në Ligj.
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.14838/12, të datë 30.06.2012, të pandehurin Xhemail Dervishi nga fshati Gradicë Komuna e Glllogocit, e ka shpall përgjegjës sepse si Zyrtar i Lartë Publik në pozitë të Drejtorit të Laboratorit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsioni, brenda afati ligjor deri më 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dh Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 1500.-€ (Njëmijë e Pesëqind euro), duke e obliguar që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 5.-€ (Pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se nuk ndihet fajtor për kundërvajtjen e cila i është vënë në barrë, se njoftimin për deklarin e pasurisë e ka marr me vonesë dhe mate më datë 07.03.2012 kurse në pozitën e drejtorit të laboratorit të AUV është vendosur dhe e ka marr aktemërimin më 21.03.2012. Më tutje thekson se në muajin mars ka patuar angazhime të shumta profesionale për çka më datën 24.03.2012 ka udhëtuar jashtë Kosove dhe është kthyer më 02.04.2012, thekson gjithashtu se dënimi i shqiptuar është shumë i lartë duke marr parasysh të ardhurat e tija mujore dhe në fund propozon që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të pezullohet procedura kundërvajtëse ndaj tij ose ti shqiptohet ndonjë dënim më arsyeshëm krahasuar me të ardhura që i realizon.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e parashtuar, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të datë 06.06.2012 me ç'rast pranon kundërvajtjen e cila i vëhet në barrë duke i paraqitur arsyet e tij për mospërbushje të obligimit ligjor, por duke u bazuar edhe në faktet tjera në shkresat e lëndës, padyshim është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, andaj ankesa e parashtuar është refuzuar si e pabazuar, ndërkaq aktvendimi i atakuar vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.



2.

Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht nuk ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale në dëm të të pandehurit, kurse sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, veprës së kryer dhe rrethanave në të cilat është kryer vepra, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktvendimit të atakuar me pezullimin të procedurës ose ti shqiptohet ndonjë dënim më i butë, siç ka propozuar i pandehuri në ankesën e paraqitur.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

GJYKATA E LARTË E KUNDËRVAJTJES NË PRISHTINË,

GJLnr.961/2012, datë 14.09.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Çunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,

Dalip Bega